



POLICIA E KOSOVËS

DREJTORIA E POLICISË NË BASHKËSI DHE PREVENTIVË
SEKTORI PËR PARANDALIM TË KRIMIT DHE DELIKUENÇS SË TË MITURVE

Kalimi i rrugës në mënyrë të sigurt në vendkalimin për këmbësorë





Pjesëmarrësit në komunikacion përfshirë edhe këmbësorët janë të obliguar tu përmbahen rregullave të komunikacionit, shenjave të komunikacionit të vendosura në rrugë si dhe shenjave dhe urdhrave të personit të autorizuar zyrtar.

ME QËLLIM TË SHMANGIES SË AKSIDENTEVE ME FATALITET APO ME LËNDIME TË RËNDA TRUPORE NXËNËSI DUHET TË:

- Përdorë trotuarin ose sipërfaqen tjetër të caktuar për lëvizjen e këmbësorëve (shtegu për këmbësor);
- Nëse nuk ka trotuar ose shteg të këmbësorëve ose përkohësisht nuk mund të përdoret, këmbësori mund të përdorë rrugën automobilistike;
- Këmbësorët duke ecur në rrugë janë të obliguar të lëvizin njëri pas tjetrit.

- Gjatë kalimit të rrugës nga një anë në anën tjetër, nxënësit duhet të sigurohen mirë gjatë kalimit të rrugës edhe nëse kalimin e bëjnë në zebra apo vendkalimin e shënuar për këmbësorë (shiko majtas, djathtas dhe prapë majtas).



Gjatë ndërrimeve të pasdites, ku nxënësit duhet të ecin nga shkolla për në shtëpi, duhet gjithsesi të përdorin ndonjë shirit apo jelek reflektues me qëllim që të vërehen nga ngasësit e veturave.

MOS KALONI RRUGËN JASHTË VENDKALIMIT TË SHËNUAR PËR KËMBËSORË!



Zakonisht, këmbësorët duhet të kenë kujdes gjatë kalimit të rrugës dhe se duhet të sigurohen që mos të shpërqendrohen gjatë kalimit të rrugës edhe nëse kalojnë në vendkalimin për këmbësorë!

**GJATË KALIMIT TË RRUGËS MOS U SHPËRQËNDRONI DUKE
BISEDUAR NË TELEFON, SHKRUAR SMS APO DËGJUAR MUZIKË!**



RAPORTONI KUNDËVAJTËSIT NË KOMUNIKACIONIN RRUGORË TË CILËT ME VEPRIMET E VETA RREZIKOJNË TË TJERËT!



 Mob: 192,  Fix: 038 92,

 e-mail: info@kosovopolice.com

 [facebook.com/KosovoPoliceZIMP](https://www.facebook.com/KosovoPoliceZIMP)